



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 36 të Rregullores (ZKA) 02/2021 Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 1732 të datës 09.09.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

## **KONKURS**

### **për plotësimin e vendit të lirë të punës**

<b>1. Pozita:</b>	<b>Zyrtar për buxhet dhe financa</b>
<b>Numri i referencës:</b>	RZBF/ZKA/18-09/22
<b>Grada:</b>	ZKA-C7
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### **Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Ndhmon udhëheqësin e divizionit në organizimin e punës së përgjithshme, si dhe kujdeset për ndërmarrjen e veprimeve financiare të përcaktuara me legjislacionin në fuqi;
- Harton planet e punës në pajtim me mbikëqyrësin për zbatimin e detyrave të përcaktuara në bazë të objektivave të divizionit dhe jep rekomandime lidhur me realizimin objektivave;
- Përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të domosdoshme për procesin buxhetor, kryen detyrën e zyrtarit zotues sipas LMFPP-së;
- Menaxhon me paranë e imët dhe avanset për ZKA-në, dhe përkujdeset që paraja e imët përdoret në përputhje me procedurat ligjore në fuqi;
- Ndhmon në menaxhimin e sistemeve përkatëse të buxhetit (Sistemi për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Buxhetit-SZHMB dhe Programi për Investime Publike-PIP) me qëllim të realizimit të pagesave dhe raportimit financiar, si dhe mbështet mbikëqyrësin në përgatitjen e raporteve periodike për ecuritë buxhetore;
- Kryen detyra tjera të ngarkuara nga Udhëheqësi i divizionit për Buxhet dhe Financa.

#### **Kualifikimet Themelore:**

- Diplomë fakulteti;
- Dy (2) vite përvojë pune profesionale, preferohet përvojë të punës në planifikim dhe analiza.

#### **Shkathtësitë e kërkuara:**

- Njohuri dhe përvojë në fushën e në fushën e buxhetit dhe financave;
- Shkathtësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internetit);

### **Informata të përgjithshme për kandidatë:**

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

### **Procedura e Aplikimit:**

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

### **Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:**

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysht. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, nga data 10.09.2022, kurse afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 25.09.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

### **Shënim:**

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.